

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

1. PËRSHKRIMI I SITUATËS

Strategjia antikorrupsion përmbledh tre prioritete kryesore në eliminimin e këtij fenomeni në sektorin e ekonomisë:

- ***Eliminimi i korrupsionit nëpërmjet përmirësimit të reformës rregullatore.***
- ***Eliminimi i korrupsionit nëpërmjet reformimit dhe përmirësimit të shërbimeve publike.***
- ***Eliminimi i korrupsionit nëpërmjet përcaktimit të standardeve të qarta në fushën e biznesit.***

Plani i veprimit i hartuar nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE) përman një sërë masash legislative, administrative dhe infrastrukturore që iu përgjigjigjen këtyre prioriteve. Ato kryesisht synojnë reduktimin e mundësive për korrupsion në shërbimet për biznesin dhe administrimin e shpërndarjen e burimeve publike, rritjen e monitorimit të brendshëm administrativ, rritjen e transparencës dhe informimit publik, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Nga vlerësimi sasior dhe cilësor i masave është arritur në konkluzionin se **nga 21 masa** që përmban Plani i Veprimit, METE **ka zbatuar 12 masa**, nga të cilat në tre raste është arritur objektivi përmes një zgjidhjeje alternative. **Tre masa janë zbatuar pjesërisht** dhe **një masë nuk është zbatuar**. Për **5 masat e mbetura**, për shkak të natyrës së pamatshme të masave ose mungesës së informacionit nga institucionet përkatëse, është **i pamundur vlerësimi i nivelit të zbatimit**.

Plani përmban një numër relativisht të lartë masash të cilat nuk janë specifikuar mjaftueshëm për të vendosur një lidhje të qartë mes objektivit, mënyrës së zbatimit dhe impaktit të synuar. Aty ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm masash ku aktivitetet përbëjnë një detyrim ligjor apo proces rutinë pune i institucioneve të përmendura. Plani shpesh adreson vetëm një pjesë të objektivave ose masat e parashikuara brenda objektivit janë të pjesshme dhe nuk e adresojnë qartë problemin.

2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË MASAVE

Objektivi 1: Reforma rregullatore e licencimit, Reduktimi i barrierave administrative ndaj nismës së lirë. Ulja e kostove të biznesit dhe zvogëlimi i hapësirave për korrupsion.

Masa 1.1: Miratimi i një udhëzimi për përmirësimin e procedurave të aplikimit të subjekteve pranë QKR.

Institucioni përgjegjës: METE, QKR

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010.

Statusi: Nuk mund të jepet një vlerësim

Marrja e informacionit apo kontaktit zyrtar me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ka qenë i pamundur. Zyra Juridike pranë METE¹ dhe raporti vjetor 2010 mbi zbatimin e Strategjisë Anti-Korrupsion² e konsideron këtë masë të zbatuar plotësisht. Hartimi i masës duket se i është përgjigjur një iniciative që adreson nevojën për përdorimin e dokumenteve elektronike të identifikimit në kryerjen e shërbimeve të ofruara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) dhe për identifikimin e shtetasve aplikues që janë pjesëmarrës në shoqëri të ndryshme. QKR gjithashtu duket të ketë kërkuar përpilimin e një projekt-vendimi për unifikimin e bazës së të dhënave personale për të gjithë subjektet që aplikojnë pranë QKR³. Në faqen zyrtare të QKR, dhe më specifikisht në udhëzimet për identifikim⁴ dhe në listën e bazës ligjore ku bazohet puna e QKR, nuk njoftohet për ndryshime në mënyrën e identifikimit të aplikuesve. Duket se mbetet në fuqi VKM Nr. 506, datë 1.8.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (Pika 9)⁵, i cili përcakton nevojën për dokument të vlefshëm identifikimi (të cilët përfshijnë dokumente joelektronikë). Gjithashtu nuk janë shpallur ndryshime të tjera në procedurat e aplikimit.

Masa 1.2: Hapja në vazhdim e sporteve të reja të regjistrimit të biznesit, rritja e kontrollit të zbatimit dhe të funksionimit të QKL.

Institucioni përgjegjës: METE, QKL

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010.

Statusi: Është zbatuar pjesërisht

Gjatë vitit 2010, janë hapur 9 sportele të reja në Shkodër, Durrës, Peshkopi, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë, Berat dhe Gjirokastër, nga 5 të planifikuara⁶. Pjesa e dytë e masës, mbi kontrollin mbi zbatimin dhe funksionimin e QKL është e paspecifikuar. Një vrojtim i pavarur i Partners Albania⁷ mbi punën e QKL i zhvilluar në periudhën prill-nëntor 2010 tregon se përdoruesit e anketuar janë të kënaqur me shërbimet e ofruara në QKL. Studimi gjithashtu raporton rritje të përdorimit të shërbimeve nga të interesuarit jashtë kryeqytetit.

Masa 1.3: Krijimi i Qendrës Kombëtare të Aplikimeve Energjetike (QKAE), përgatitja e akteve ligjore për funksionimin e kësaj qendre.

Institucioni përgjegjës: METE, QKAE

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010.

Statusi: E zbatuar (nëpërmjet një zgjidhje alternative)

¹ Intervistë me Zamir Stefani dhe Fatjona Kuka – Drejtorja e Shërbimeve Ligjore, METE, 26.04. 2011

² Prezantim nga Helena Papa. Tirane, dt. 16 Qershor 2011, në Forumin e PACA “Plan Veprimi anti-korrupsion 2011-2013 dhe roli i OJQ-ve”, Hotel Tirana International

³ Sipas eksperteve në Zyrën Juridike dhe Dejtorinë e Politikave Rregullatore të METE. 26 Prill 2011

⁴ http://www.qkr.gov.al/nrc/How_to_Register_a_Business.aspx

⁵ Pika 9. Personi, që paraqet aplikimin në sportel, duhet të vërtetojë identitetin me një dokument të vlefshëm identifikimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi. (Ligji nr. 9723 për QKR, datë 3.5.2007)

⁶ Gjashtë sportele të raportuara deri në mars, 9 deri në prill.

⁷ http://www.partnersalbania.org/Monitorimi_QKL_Raport_Shqip_English.pdf

Në adresimin e kësaj çështjeje është ndjekur një rrugë alternative dhe shërbimet e aplikimeve energjitike i janë ngarkuar Qendrës Kombëtare të Licencimit. Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 385 datë 19.05.2010 “Për një Shtesë në Vendimin Nr. 538, Datë 26.5.2009 të Këshillit Të Ministrave “Për Licencat dhe Lejet që Trajtohen nga apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Disa Rregullime të Tjera Nënligjore të Përbashkëta”, të Ndryshuar”⁸. Ky vendim shfuqizon Vendimin Nr. 913, datë 26.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike”, dhe përcakton datën 09.06.2010 si afatin e fillimit të procedurave të licencimit të aplikimeve të energjisë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit⁹.

Objektivi 2. Rritja e transparencës në administrimin dhe privatizimin e pronës publike. Shkurtimi i afatit të procedurave të privatizimit duke hequr procedurat e prononcimit të ministrive mbi objektet që kanë në administrim.

Masa 2.1 Hartimi i urdhrin mbi marrjen e masave për identifikimin e asetëve shtetërore që do të përfshihen në procesin e privatizimit.

Institucioni përgjegjës: METE në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës që kanë në administrim objektet që privatizohen - DASHPP

Afati i zbatimit: 3 muhori i parë i vitit 2010

Statusi: E zbatuar (jashtë afati)

Është hartuar urdhri Nr. 77, datë 5.4.2010 për: “Marrjen e Masave për Identifikimin e Asetëve Shtetërore që do të Përfshihen në Procesin e Privatizimit”. Urdhri kërkon që brenda datës 10.04.2010 ministrinë¹⁰ të bëjnë identifikimin e asetëve shtetërore që do të përfshihen në procesin e privatizimit dhe të asetëve publike që mund të jepen me koncesion, informacion i cili duhet t’i dërgohet METE. Urdhri gjithashtu përcakton llojin e pronave të përfshira, detyrimin e Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për bashkëpunim, si dhe mënyrën e raportimit. Pas dërgimit të listave, në bazë të Vendimit nr. 1638 date 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, ministrive të linjës u kërkohet të caktojnë përfaqësues në komisionet e vlerësimit të objekteve në procedure privatizimi. Sipas Drejtorisë së Privatizimit pranë METE¹¹, procesi është zbatuar me sukses dhe pranë kësaj drejtorie janë sjellë listat përkatëse për 1280 objekte shtetërore.

Objektivi 3. Parandalimi i korrupsionit nëpërmjet procedurave elektronike të tenderëve

Masa 3.1: Garantimi i aksesit nëpërmjet internetit në dokumentet e tenderimeve.

Institucioni përgjegjës: DSHJ(METE)

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: E zbatuar

⁸ http://qpz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2010/PDF-2010/75-2010.pdf fq. 3981

⁹ Që funksionon në bazë të Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSh“

¹⁰ Përvec Ministrisë së Integritimit

¹¹ Genti Minarolli, Drejtor, Drejtoria e Privatizimit, METE – intervistë datë 1. 06. 2011

Masa përbën një detyrim ligjor të institucionit, në zbatim të ligjit “Për Prokurimin Publik” dhe VKM Nr.45, Datë 21.01.2009 “Për Kryerjen e Procedurave në Mënyrë Elektronike”¹². Nuk ekziston një sistem i brendshëm monitorimi në METE për aksesin online të dokumenteve të tenderëve¹³. Kjo e bën të vështirë monitorimin e brendshëm dhe të jashtëm të zbatimit të kësaj mase. Raportet e palëve të treta dhe medias mbi tenderimet online nuk tregojnë për probleme në aksesin e dokumenteve të tenderimit online. Në një plan më të gjerë, Shqipëria është vlerësuar për arritjet në këtë fushë edhe në nivel ndërkombëtar¹⁴. Komisioni i Prokurimit Publik¹⁵, i krijuar në Prill 2010, shqyrton ankesat e operatoreve ekonomikë në lidhje me procedurat e tenderimeve (kryer më parë nga Drejtoria e Ankesave dhe Asistencës Ligjore për Prokurimet) dhe dorëzon një raport vjetor në Këshillin e Ministrave. Ndërkohë, zbatimi i ligjit kontrollohet nga Auditi i Brendshëm në METE dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raporti i APP mbi shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë për periudhën Janar-Prill 2010 flet për 46 ankesa për procedura prokurimi, nga ku janë marrë vendime për ndryshime në dokumentet e tenderit në 4 raste, dhe për anulim tenderi në 6 raste. Megjithatë, këto të dhëna nuk kategorizohen sipas ministrive apo llojit të problemeve të hasura. Në prill 2010 Komisionit të Prokurimit Publik iu kaluan 65 raste në shqyrtim dhe iu referuan me vonë 92 raste ankimi në APP.¹⁶ Nga një vlerësim i Dhomës Amerikane të Tregtisë¹⁷ publikuar në shtator 2010, shumica e operatorëve ekonomikë të vrojtuar e vlerësojnë aksesin dhe përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik si pozitiv. Të dhënat në këtë raport jepen në bazë zone gjeografike (dhe jo sipas institucioneve kontraktuese).

Masa 3.2: Sigurimi i vazhdimësisë së publikimit elektronik të fituesve / kontraktorëve.

Institucioni përgjegjës: DSHB(METE)

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Adresimi i kësaj mase raportohet i zbatuar nga ana e institucioneve përgjegjëse. Gjithsesi, vlen të theksohet se vlerësimet e mësipërme për masën 3.1. në lidhje me indikatorët e monitorimit mbeten relevante edhe për këtë masë.

Masa 3.3: Përmirësimi e rritja e efektshmërisë së sistemit të prokurimit elektronik.

Institucioni përgjegjës: DSHJ(METE)

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Nuk është e qartë nëse masa i referohet çështjeve të infrastrukturës apo atyre ligjore. Masa gjithashtu nuk është shoqëruar me tregues matës. Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur iniciativa nga METE, e cila luan një rol zbatues përse i përket prokurimit publik. Ka pasur ndryshime të

¹² <https://www.app.gov.al/ep/VKM.aspx>

¹³ Gresa Martini, Drejtorja e Prokurimeve – intervistë 26 Prill 2011

¹⁴ Shqipërisë iu akordua nga Kombet e Bashkuara vendi i dytë si fitues për Çmimin e Shërbimeve Publike, në kategorinë "Përmirësimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe përgjigjshmërisë në Shërbimin Publik".

¹⁵ Sipas Nenit 19, LIGJI Nr.9643, dt 20.11.2006, Ndryshuar me Ligjin Nr.9800 dt 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855 dt 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, dt 22.10.2009, dhe Ligjin Nr.10 309, dt 22.07.2010

¹⁶ Raporti Vjetor 2010 i APP. Fq.13-14 <https://www.app.gov.al/ep/ReportsMonitorings.aspx>

¹⁷ Monitorimi i Përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik. Raporti Përfundimtar. <https://www.app.gov.al/ep/ReportsMonitorings.aspx>

akteve nën/ligjore për APP për të përmirësuar sistemin e prokurimit, një pjesë e të cilave i referohen drejtpërdrejt sistemit elektronik. Ndryshimet ligjore kanë pasur kryesisht të bëjnë me kalimin e kompetencave të shqyrtimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përfshirë Koncesionet dhe Ankandet Publike¹⁸. Aktet nënligjore të nxjerra nga APP që lidhen drejtpërdrejt me procedurat elektronike janë:

- Udhëzim për krijimin dhe vlerësimin e dosjes së tenderit me mjete elektronike (procedura pa lot-e dhe procedura me lot-e);
- Udhëzim Nr. 02, Date 17.05.10, “Për modifikimin e dokumenteve dhe shtyrjen e afatit në sistemin e prokurimit elektronik”;
- Udhëzim nr. 03, Date 01.06.10, “Per shpalljen e njoftimit te kontratës, njoftimit te fituesit dhe njoftimit te kontratës se lidhur, ne sistemin e prokurimit elektronik”

Masa 3.4: Kryerja e te gjitha tenderëve në rrugë elektronike

Institucioni përgjegjës: DSHB(METE)

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: I zbatuar

Adresimi i kësaj mase raportohet i zbatuar nga ana e institucioneve përgjegjëse. Gjithsesi, vlen të theksohet se vlerësimet e mësipërme (shih masën 3.1. dhe 3.2.) në lidhje me indikatorët e monitorimit mbeten relevante edhe për këtë masë

Objektivi 4 - Masat e marra për luftën kundër korrupsionit për garantimin e transparencës aktive të institucionit dhe për transparencën e bazuar në kërkesat për informimin e publikut

Masa 4.1: Plotësimi dhe azhurnimi i faqes elektronike në drejtim të kuadrit ligjor si dhe të udhëzimeve në të gjitha fushat që mbulon METE.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: E zbatuar

Masa përbën detyrim ligjor në zbatim të ligjit “Për të Drejtën e Informimit” dhe detyrë rutinë të institucionit. Me ndihmën e Bankës Botërore¹⁹ është krijuar dhe është tashmë funksional online *Regjistri i Elektronik i Legjislacionit të Biznesit*: <http://www.rlb.gov.al/>. Ky portal ofron një bazë të pasur të informacionit dhe aksesit ndaj legjislacionit (rreth 1400 akte) dhe projekt-akteve. Aktet janë gjithashtu të organizuara sipas një liste të gjerë institucionesh dhe mund të kërkohen edhe përmes një motori kërkimi online. Në faqen elektronike të METE gjithashtu ekziston një bazë informacioni mbi legjislacionin bazë. Burime të tjera

¹⁸ VKM nr.398, datë 26.05.2010 Per Amendime ne Rregullat e Prokurimit Publik – për shkak të ndryshimeve në ligjin nga ligji Nr. 10170, datë 22.10.2009, “Per disa ndryshime në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Ligji nr. 10 309, datë 22.7.2010 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, date 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Ligji nr. 9663, date 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar ka ndryshuar me Ligjin Nr. 10281, date 20.05.2010 “ Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine ligjit, Nr.1, date 05.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Për Koncesionet”. Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, u ndryshua me ligjin nr. Nr.10 346, datë 4.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”.

¹⁹ Projekt i Bankës Botërore: Business Environment Reform and Institutional Strengthening”

informacioni sektorial përfshijnë www.privatizime.al si dhe faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Licensimit (www.qkl.gov.al) dhe të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (www.qkr.gov.al). Deri në vitin 2010 përditësimi i faqes elektronike të METE është kryer në bazë të një urdhëri Ministror, me anë të të cilit çdo drejtorie i kërkohej të përcakonte një person përgjegjës për përditësimin e faqes. Gjatë vitit 2011 është punuar për ndërtimin e një faqeje të re. Gjatë kësaj periudhe të gjitha detyrat e përditësimin i janë kaluar Drejtorisë së Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit, e cila konsultohet me drejtorinë përkatëse për përmbajtjen e përditësimin. Monitorimi i përmbajtjes dhe përditësimin të faqes bëhet përmes një raporti javor që dorëzohet pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në METE²⁰.

Masa 4.2: Materialet informuese të tjera, sipas parashikimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” do të jenë në çdo moment të disponueshme në Zyrën e Informimit të publikut, pa pagesë .

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: E zbatuar (rrugë alternative)

Vlerësimi i zbatimit të kësaj mase është i vështirë pasi masa është e përgjithshme dhe nuk është shoqëruar me tregues matës. Zyra për Informimin e Publikut pranë METE nuk disponon apo shpërndan broshura për informimin e publikut, megjithëse kjo zyrë bën të ditur se ka shpërndarë në të kaluarën broshura informimi mbi mbrojtjen e konsumatorit²¹. Megjithatë, ekzistojnë një numër mekanizmesh të tjerë për informim dhe komunikim me publikun. Zyra për Informimin e Publikut është e hapur dhe vë në dispozicion të publikut adresën e saj postare, adresën e drejtuesit të zyrës, dhe një kuti postare për pyetje e komente, përgjigja ndaj të cilave sipas ligjit duhet të jepet brenda një periudhe kohore prej 41 ditësh kalendarike. Në dispozicion të publikut, përveç faqeve elektronike të përmendura në pikën 4.1. ekziston edhe nr. 0800 2006 për informimin e publikut.

Objektivi 5: Lehtësimi dhe inkurajimi i financimit të siguruar mbi pasuritë e luajtshme. Sigurimi i zbatueshmërisë së ligjit mbi pretendimet pasurore mbi pasuritë e luajtshme.

Masa 5.1: Procedimi i transaksioneve të barreve sigurorese.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: E zbatuar (rrugë alternative)

Transaksionet e barrëve sigurorese u referohen regjistrimeve/bllokimeve të pasurive të luajtshme dhe përdorimit të këtyre pasurive si kolateral sigures në marrëveshje të ndryshme mes individëve apo mes individëve dhe kompanive. Deri në vitin 2009, këto shërbime ofroheshin nga Ministria e Financave. Nga Prill 2009, në bazë të një marrëveshjeje koncesionare, shërbimet publike të regjistrimit të pasurive të luajtshme ofrohen nga kompania private “Regjistri i Barrëve Sigurorese” (RBS). METE dhe RBS nuk e bëjnë publike marrëveshjen e koncesionit. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje, nuk mund të vijëzohen qartë

²⁰ Interviste (23.05.2011) me Helidon Begaj (Drejtorja e Teknologjisë) dhe Fatjon Kosta (Përgjegjës IT).

²¹ Interviste (23.05.2011) me Helidon Begaj dhe Brunilda Braho – Shefe e Informacionit.

apo të monitorohen përgjegjësitë e kompanisë koncesionare dhe të METE në ofrimin e këtij shërbimi publik. Pranë METE gjithashtu nuk ka qartësi mbi pikat e reja të kontaktit apo përgjegjësisë në këtë fushë dhe monitorimi është mbështetur kryesisht në bashkëpunimin e kompanisë RBS. RBS funksionon në një kuadër ligjor të përcaktuar nga Ligj, Nr. 8537, Datë 18.10.1999, Për Barrët Siguruese (ndryshuar në 2006²² dhe 2009²³) dhe nga urdhrat dhe udhëzimet mbi Tarifat e Shërbimit²⁴, formularët, rregulloren e Barrëve Siguruese²⁵ dhe Udhëzuesin e vitit 2001 për Kryerrgjistruesin.

Sipas RBS, shërbimet e regjistrimit të pasurive të paluajtshme kanë vijuar pa probleme dhe është rritur shpejtësia dhe cilësia e shërbimit, falë sistemit më të avancuar kompjuterik dhe lidhjet e RBS me noterët në rrethe (përmes postës elektronike). Sipas RBS, koha e regjistrimit është ulur nga një jave, në një ditë dhe numri i regjistrimeve mujore varion nga 800-1000 regjistrime. Sipas Drejtorisë Juridike të METE dhe RBS, marrëveshja e koncesionit parashikon të drejtën e Ministrisë të Ekonomisë dhe Zv. Ministrave të Ekonomisë për të kërkuar monitorime, kontrole apo shpjegime ad-hoc mbi këtë regjistër²⁶. Pranë METE nuk ka dijeni të një veprimi të tillë deri në qershor 2011 dhe nuk disponohet ndonjë raport për këtë fushë.

Masa 5.2: Mirëadministrimi i informacionit të ruajtur në sistemin e Regjistrimit.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: Nuk mund të jepet një vlerësim

Nuk ka raporte qeveritare apo raporte të pavarura mbi cilësinë e administrimit të informacionit në sistemin e regjistrimit. Sipas RBS, sistemi kompjuterik i përdorur dhe kopjimi i të dhënave ofrojnë siguri të lartë të informacionit. RBS gjithashtu deklaron se marrëveshja koncesionare parashikon gjoha të larta në raste gabimesh nga operatori koncesionar²⁷. Në mungesë të marrëveshjes koncesionare apo raporteve, nuk mund të jepet vlerësim mbi detyrimet ligjore apo performancën e deritanishme në këtë drejtim.

Masa 5.3: Monitorimi i informacionit mbi transaksionet financiare që kryejnë subjektet në Regjistër.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: Nuk mund të jepet një vlerësim

Masa kontribuon drejt zbatueshmërisë dhe përmirësimit të shërbimit dhe politikëbërjes, por nuk është detajuar mjaftueshëm (mekanizmat, investimet, linjat e raportimit). Vlerësimi i

²² Ligji Nr. 9524, dt 25.04.2006 “Për Një Ndryshim Në Ligjin Nr.8537, dt 18.10.1999 Për Barrët Siguruese.

²³ Ligji 10185, Datë 26.11.2009 Për Një Ndryshim Dhe Një Shtesë Në Ligjin Nr. 8537, Datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”, Të Ndryshuar - (Për Kërkesat Me Shkrim Për Informacion)

²⁴ Urdhër Nr. 494, Date 06.07.2006 Mbi Tarifat e Shërbimit të Regjistrimit të Barreve Siguruese (METE)

²⁵ Urdhër Nr. 493, Datë 06/ 07/ 2006 Për Miratimin E Rregullores Së Barrëve Siguruese (që shfuqizoi Udhëzimi Nr. 6278, Date 11.12.2000 “Për Miratimin E Rregullores Se Barreve Siguruese”)

²⁶ Brunilda Jegeni, Administratore e Përgjithshme, RBS – Intervistë dt. 20.06.2011

²⁷ Brunilda Jegeni, Administratore e Përgjithshme, RBS – Intervistë dt. 20.06.2011

jashtëm në mungesë të marrëveshjes së koncesionit dhe raporteve të brendshme apo të jashtme të METE është i pamundur²⁸.

Masa 5.4: Dhënie e asistencës legislative dhe teknike mbi procedurat e kryerjes së transaksioneve në Regjistër.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: Gjate vitit 2010

Statusi: Nuk është zbatuar

Masa kontribuon drejt inkurajimit dhe lehtësimit të përdorimit të shërbimit. Sërish, nuk janë detajuar mekanizmat, investimet, apo format e asistencës. Gjithashtu nuk është e qartë nëse kjo asistencë presupozohet t'i drejtohet kompanisë koncesionare apo publikut.

RBS ofron vetëm asistencë teknike në aspektet procedurale dhe plotësimin e formularëve. METE nuk ofron asnjë lloj shërbimi ndaj publikut në këtë drejtim.

Objektivi 6. Reduktimi i hapësirave për korrupsion nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit periodik dhe vjetor të ecurisë së zbatimit të projekteve me financim të huaj.

Masa 6.1: Marrja e masave për tërheqjen në kohë dhe në mënyrë profesionale të informacioneve nga njësitë që zbatojnë ose menaxhojnë projekte me financim të huaj, nga drejtoritë e politikave dhe nga institucionet e varësisë.

Institucioni përgjegjës: DPP

Afati i zbatimit: Çdo dy muaj (monitorimi periodik). Dhjetor 2010 (monitorimi vjetor).

Statusi: Nuk mund të jepet një vlerësim

Monitorimi dhe vlerësimi periodik i projekteve të financuara me ndihmë të huaj është një proces rutinë i institucionit. Masa nuk përcakton mënyrat e përmirësimit të procesit të marrjes së informacionit. Raportimet e METE për përdorimin e ndihmës së huaj janë tre-mujore dhe kumulative²⁹. Ato bazohen në të dhënat e mbledhura nga zbatuesit e projekteve me financim të huaj. Raportet dorëzohen pranë Ministrisë të Ekonomisë, Ministrisë së Financave dhe pranë Departamentit të Bashkëndimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON), i cili harton raportin e përmbledhur vjetor për të gjitha institucionet. Nuk ka pasur përgjigje nga METE në lidhje me raportet dy-mujore. Raporti vjetor i DEBASKON është i organizuar sipas sektorëve (dhe jo sipas ministrive). Nuk ka dalë një raport i tillë për vitin 2009 dhe raporti që pritet të mbulojë vitin 2009 dhe vitin 2010 pritet të dalë në periudhën korrik-gusht 2011³⁰. Në mungesë të raporteve të brendshme të METE dhe të raporteve të Departamentit të Koordinimit të Ndihmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave, nuk mund të jepen vlerësime mbi përmbajtjen e përshtatshmërinë e këtyre raporteve me objektivin.

²⁸ Ligji 10185, Dt 26.11.2009 "Për një Ndryshim dhe një Shtesë Në Ligjin Nr. 8537, Datë 18.10.1999 "Për Barrët Siguruese" shënon ndryshime pozitive për aksesin e noterëve apo publikut tek informacioni në regjistër (E drejta për informim me anë të kërkesave me shkrim drejtuar Regjistri i Barrëve Siguruese).

²⁹ Intervistë me dy eksperte të Departamentit Financiar, METE, 27.04. 2011

³⁰ Josif Gjani dhe Florensa Haxhi, DEBASKON - Intervistë 1.07.2011

Masa 6.2: Përpunimi i informacionit të marrë dhe evidentimi i problemeve të dalta gjatë zbatimit të projekteve dhe dhënia e rekomandimeve për zgjidhjen e tyre.

Institucioni përgjegjës: DPS

Afati i zbatimit: Çdo dy muaj (monitorimi periodik). Dhjetor 2010 (monitorimi vjetor).

Statusi: Nuk mund të jepet një vlerësim

Në mungesë të raporteve të METE, nuk mund të jepet një vlerësim për këtë pikë. Raporti vjetor i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) mbi përdorimin e ndihmës së huaj nuk e adreson këtë çështje. Megjithatë, çështjet e zbatimit të projekteve mund të ngrihen në disa forume si: pikat e kontaktit në Ministri (zakonisht Drejtoria e Integritit), grupet sektoriale të punës, dhe në nivelin më të lartë, në Komitetin e Politikave dhe Strategjive (KPS).

Objektivi 7. Sigurimi i transparencës në përdorimin e fondeve publike. Lehtësimi i informimit mbi skemat e ndihmës shtetërore

Masa 7.1: Kontrolli i skemave dhe ndihmave individuale i vitit 2009 nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore dhe Komisionit Evropian për mënyrën e zbatimit të këtyre ndihmave shtetërore, nëse ka keqpërdorime të tyre.

Institucioni përgjegjës: Ministrinë e Linjës, DNSH/KNSH (METE)

Afati i zbatimit: 3 muajori i dyte i vitit 2010

Statusi: Është zbatuar pjesërisht

Nuk ekziston një raport i Komisionit të Ndhmës Shtetërore apo i Komisionit Evropian mbi këtë fushë. Është përgatitur Raporti i Ndhmës Shtetërore 2009, i cili jep informacion mbi situatën ekonomike, detyrimet shtetërore për raportim në kuadër të MSA dhe CEFTA, ndryshimet ligjore dhe ndarjet sipas llojit të ndihmës dhe instrumenteve të ndihmës (horizontale dhe vertikale)³¹. Në raport nuk jepen vlerësime mbi cilësinë e zbatimit të skemave apo përdorimit të tyre, të cilave u referohet masa.

Masa 7.2: Hartimi dhe miratimi i VKM-se “Për miratimin e raportit për ndihmat shtetërore”

Institucioni përgjegjës: Ministrinë e Linjës, DNSH/KNSH (METE)

Afati i zbatimit: 3 muajori i dyte i vitit 2010

Statusi: E zbatuar (jashtë afati)

VKM Nr. 635, dt. 23.07.2010 “Për miratimin e raportit për ndihmat shtetërore”.

Masa 7.3: Dërgimi pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe Komisionit Evropian

Institucioni përgjegjës: Ministrinë e Linjës, DNSH/KNSH (METE)

Afati i zbatimit: 3 muajori i dyte i vitit 2010

Statusi: E zbatuar (jashtë afatit)

Është dorëzuar raporti pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe Komisionit Evropian.

³¹ Anila Jani, Drejtoreshë dhe Joniada Zaimaj, Drejtoria e Ndhmës Shtetërore - Interviste 16.03. 2011

Objektivi 8: Bashkëpunimi me institucionet e tjera të pavarura, me qëllim rritjen e shkallës së zbatimit të ligjit. Në veçanti bashkëpunimi me prokurorinë për të siguruar transparencë dhe ndëshkim të korrupsionit.

Masa 8.1: Hetimi dhe ndëshkimi administrativ me masa disiplinore të çdo rasti të abuzimit me detyrën, ose të korrupsionit nga ana e zyrtareve si dhe bërja e kallëzimit penal pa asnjë hezitim për cilindo person të përfshire në korrupsion

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: 2010

Statusi: E zbatuar

Masa përbën zbatim të detyrimeve ligjore dhe nuk specifikon mekanizmat, rregullimin ndërinstitucional apo kapacitetet e kërkuara në këtë proces. Treguesit monitorues për këtë masë janë të pamatshëm dhe rrjedhimisht, mund të bëhet vetëm një vlerësim i përgjithshëm i aktiviteteve në këtë fushë. Auditit i Brendshëm pranë METE përgatit dhe publikon raporte periodike të kontrollit të brendshëm³², të cilët dorëzohen pranë Ministrit dhe pranë Departamentit të Kontrollit Administrativ dhe Anti-Korrupsionit pranë Këshillit të Ministrave, i cili përgatit një raport të përgjithshëm për të gjitha institucionet e përfshira. Departamentit i Kontrollit Administrativ dhe Anti-Korrupsionit pranë Këshillit të Ministrave gjithashtu ndërmerr inspektime administrative ad-hoc. Gjithashtu pritet të nënshkruhet një Memorandum Bashkëpunimi mes këtij departamenti dhe Prokurorisë së Përgjithshme, i cili nuk është arritur ende. Në zbatim të Urdhrit nr. 70, dt. 18.04.2006 “Për Masat e Marra në Zbatim të Raporteve të KLSH, Auditit të Brendshëm dhe DEBASKON, në Këshillin e Ministrave, në Institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”, përgatitet edhe “Raport i përgjithshëm vjetor për masat e mara në zbatim të raporteve të KLSH, DEBASKON dhe Auditit të Brendshëm”, që dorëzohet pranë Zyrës së Zv. Kryeministrit. Gjatë vitit 2010 Departamenti i Auditit të Brendshëm (DAB) pranë METE ka kryer 40 auditime mbi rregullshmërinë dhe ligjshmërinë dhe 12 auditime vlerësuese e tematike në ndërmarrje shtetërore, shoqëri anonime, agjensi, drejtori e drejtori të përgjithshme, degë të shoqërive publike pranë Prefekturave në rrethe dhe të tjera³³. Raporti konstaton ulje të dëmit ekonomik dhe rritje të zbatimit të masave të propozuara nga DAB. Është evidentuar dëm ekonomik i përgjithshëm prej 111.688 mije leke, ose 63.810 mijë lekë me pak nga viti 2009³⁴. Evazioni fiskal përbën 40 % të dëmit ekonomik për 2010 ndërsa shkeljet të disiplinës financiare me dëm ekonomik përbëjnë 50 % të vlerës totale të dëmit.

Për vitin 2010, janë dhënë nga DAB gjithsej 746 rekomandime dhe propozime për përmirësimin e sistemeve të organizimit të kontrollit të brendshëm, për masa administrative ndaj personave (ku 10 janë drejtues entitetesh), dhe për zhdëmtime ekonomike. Niveli i zbatimit të rekomandive për vitin 2010 raportohet të ketë qenë i kënaqshëm, ndërsa arkëtimet për zhdëmtimet ekonomike janë në nivele të ulëta. Raporti jep vlerësimin se nga 268 rekomandime të dhëna në 24 entitete, 152 rekomandime janë zbatuar, 88 rekomandime

³² Ertrit Sofroni, Drejtor, Departamenti i Auditit të Brendshëm, Intervistë 17.03.2011

³³ Strukturat e Ministrisë në shumën 74.294 mijë lekë, ose 90.214 mijë lekë me pak nga 2009 dhe struktura e auditit në subjektet e varesisë në shumën 37.394 mije leke, ose 26.404 mije leke me shumë se viti 2009.

³⁴ Raport mbi Veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në METE, Për Vitin 2010 http://mete.gov.al/doc/20110331104344_raport_vjetor_dab_2010.pdf

vlërësohen të realizuara pjesërisht (në ndjekje dhe në proces realizimi) dhe 28 rekomandime nuk janë realizuar. Nga vlera totale ngarkuar për zhdëmtim, në shumën 36.918.190 lekë dhe 11.718,45 euro janë arkëtuar vetëm shumat 929.093 leke dhe 4.211,45 Euro. Nuk ka informacion mbi kallëzimet penale.

Objektivi 9: Përmirësimi i Teknologjisë së informacionit konform programeve bashkëkohore për njohjen me strategjinë e përcaktuar në Programin e Qeverisë për luftën kundër korrupsionit.

Masa 9.1: Publikimi në web site të METE të të gjitha evidentimeve, zbulimeve, shkeljeve financiare me dëm ekonomik dhe procedurave ligjore me rekomandimet përkatëse për çdo rast.

Institucioni përgjegjës: METE

Afati i zbatimit: 2010

Statusi: E zbatuar pjesërisht

Pas muajit mars 2011, janë publikuar në faqen elektronike të METE Raporti Vjetor dhe raportet tre-mujore mbi Veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në METE. Këto raporte ofrojnë statistika agregate dhe nuk i referohen rasteve të shkeljeve dhe rekomandimeve specifike.

3. VLERËSIMI CILËSOR I PROGRESIT

Progresi sipas sektoreve

Duhet theksuar se luftimi i korrupsionit është një proces i vazhdueshëm ndër-sektorial, ku përcaktimi dhe matja i treguesve finalë të suksesit është i vështirë, sidomos në mungesë të studimeve apo shifrave për vlerësimin e ndikimit të reformave përkatëse.

Megjithatë në një vlerësim cilësor, arrijmë në përfundimin se masat e PV 2010 që synojnë ndryshime specifike janë vetëm ato që lidhen me hapjen e sporteve të reja të QKL (Masa 1.2), me funksionimin e QKAE (Masa 1.3) dhe me privatizimin (Masa 2.1). Suksesi në këto drejtime vlerësohet të ketë eventualisht një ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e mundësive për korrupsion. Masa të tjera, si prokurimi online dhe informimi, janë të rëndësishme për zbatimin e reformave të viteve të kaluara. Ndërkohë ndikimi apo arritjet në fushat e tjera të këtij plani janë të pamatshme ose të ulëta.

Sfidat

Në tërësinë e tij, Plani i Veprimit Anti-Korrupsion 2010 përbëhet nga masa zbatimi i të cilave kontribuon në arritjen e objektivave të planit vjetor. Megjithatë, gjatë studimit të planit të veprimit dhe procesit të monitorimit janë evidentuar disa probleme që ndikojnë në nivelin e zbatueshmërisë së planit si dhe në ndikimin e masave që ai përmban. Ato mund të

kategorizohen në probleme që lidhen me përshtatshmërinë dhe dhe mjetueshmërinë e planit si dhe në probleme të zbatimit e vlerësimit të impaktit.

- **Plani i Veprimit**

Një nga problemet kryesore që lidhet me cilësinë e Planit të Veprimit 2010 është specifikimi masave dhe relevanca me objektivin. Kështu, një numër relativisht të lartë masash **nuk janë specifikuar mjaftueshëm** për të vendosur një lidhje të qartë mes objektivit, mënyrës së zbatimit dhe ndikimit të synuar. Shpesh *treguesit monitorues* mbeten të shprehur në formën e masave apo objektivave, arritjen e të cilave synojnë të masin (rasti i objektivit 3 mbi tenderimet elektronike, objektivit 4 mbi përditësimin e faqes së METE, objektivit 5 mbi transaksionet siguroese me pasuri të luajtshme, një pjesë të objektivit 6 mbi ndihmën e huaj). Gjithashtu, në rastet kur masat i referohen akteve specifike ligjore apo raporteve të monitorimit nuk bëhet e qartë lidhja mes objektivave dhe përmbajtjes së këtyre dokumenteve. Në rastin e raporteve të ndihmës shtetërore dhe ndihmës së huaj, vërehet mospërputhje mes përmbajtjes së këtyre raporteve dhe synimit të objektivave. Kjo sugjeron që këto raporte hartohen për qëllime të tjera dhe nuk i përgjigjen objektivave të luftës kundër korrupsionit. Ato konsistojnë kryesisht në paraqitje përshkruese, agregate të dhënash dhe jo në analiza strategjike që shoqërohen me rekomandime përkatëse.

Në Planin e Veprimit 2010 ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm masash që **nuk mund të konsiderohen veprime strategjike** pasi përbëjnë një *detyrim ligjor* apo një *proces rutinë* pune të institucioneve të përmendura. Të tilla janë sidomos masat që lidhen me tenderimin elektronik (Objektivi 3), përditësimin e faqes së METE (Objektivi 4), transaksionet siguroese me pasuritë e luajtshme (Objektivi 5), si dhe hetimin dhe ndëshkimin administrativ (Objektivi 8 dhe 9). Në këto fusha, numri i masave duhet të reduktohet dhe në bazë të kuadrit një-vjeçar të zbatimit dhe në rastet e nevojshme, duhet specifikuar se si masat synojnë të përmirësojnë zbatueshmërinë e ligjeve në fuqi.

Plani përmban raste ku **masat janë të pjesshme** në adresimin e objektivave (objektivi 7 - informimi mbi skemat shtetërore mbetet i paadresuar). Në këto raste sugjerohet ngushtimi i objektivave vjetore ose paraqitja e objektivave/masave afatmesme. Ka gjithashtu objektiva (objektivi 8 mbi hetimin dhe ndëshkimin) ku mund të argumentohet se masat janë të pjesshme në qasjen ndaj problemit³⁵. Në rastin e objektivit 8 masat do të ishin më të plota nëse gjithashtu adresonin problemet e pavarësisë institucionale dhe përgjegjësisë për zbatimin e rekomandimeve.

Anjë nga masat e PV 2010 për METE **nuk janë shoqëruar me buxhetin apo alokimin e burimeve** të kërkuara për zbatimin e tyre.

³⁵ Këtu gjithashtu do të ishte me vlerë evidentimi i objektivit si afatmesëm apo afatgjatë, nëse është i tillë dhe nëse këto lloj masash planifikohen të ndërmerren në vitet pasardhëse.

Mangësi të tjera të planit janë mungesa në përgjithësi e **referimit ndaj strategjisë anti-korrupsion dhe kategorizimit të kohëzgjatjes** së zbatimit të masave. Nuk është e qartë nëse masat e përmendura janë masa afatshkurtra apo elemente vjetorë të një plani më afatmesëm apo afatgjatë. Planit rrjedhimisht i mungon paraqitja e **vazhdimësisë** mbi përpjekjet, sukseset apo vështirësitë e viteve të mëparshme.

Këta faktorë e dëmtojnë zbatimin masave. Ato gjithashtu pengojnë analizën kritike të ndërhyrjeve të tjera që mund të kërkohen për arritjen e objektivave të renditura.

- **Institucionet**

Niveli i ndërgjegjësimit apo ndjeshmërisë së administratës përkundrejt Planit të Veprimit duket të jetë i ulët. Në disa raste, përveç mungesës së dijenisë apo copëzimit të veprimit sipas drejtorive apo enteve specifike, vërehet edhe mungesë e pronësisë së përmbajtjes së planit apo dakordësisë mbi vlefshmërinë e masave që ai përmban. Shembuj kritikë vijnë nga rastet kur ka ndryshime si psh. anulimi i ngritjes së një qendre të veçantë për aplikimet e energjisë apo dhënia me koncesion e shërbimeve të transaksioneve siguroese të barrëve të luajtshme. Në të dy rastet, stafi i METE është i paqartë për zgjidhjet e dhëna, rolin e ri të METE, apo departamentet/individët përgjegjës për këto fusha. Cilësia dhe pronësia mbi planin e veprimit do të përmirësohej përmes një *procesi planifikimi konsultues gjithëpërfshirës* dhe përmes trajtimit të planit si një instrument strategjik, të integruar, i cili kërkon *bashkëpunim mes sektorëve dhe pronësi politike e drejtuese* të ministrisë përkatëse.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme është ndarja e **institucioneve përgjegjëse**, e cila ndikohet negativisht nga ndryshimet e shpeshta në strukturën e Ministrisë, përcaktimi i pasaktë i institucioneve përgjegjëse (si psh tek prokurimi), mungesa e komunikimit mes aktorëve që duhet të bashkëpunojnë si dhe mungesa e paraqitjes së lidhjes me ente të pavarura (prokurimi, privatizimi).

- **Matja dhe raportimi**

Së fundit, dy drejtime të tjera në të cilat do të duhej të zhvilloheshin thuajse të gjitha masat janë: ngritja dhe institucionalizimi i mekanizmave për **matjen e ndikimit** dhe publikimi i të dhënave mbi zbatimin e politikave anti-korrupsion.

Matja e ndikimit mund të arrihet duke:

- përcaktuar vlerësimet paraprake të situatës (*baseline*),
- forcuar komunikimin ndërinstitucional,
- vlerësuar ndryshimin e treguesve kryesorë (sasiorë dhe cilësorë),
- matur nivelin e kënaqësisë të përdoruesve me shërbimet dhe informacionin.

Kjo është sidomos e rëndësishme në fushat si regjistrimi e licencimi për bizneset, ndihma shtetërore, privatizimi dhe prokurimi - ku një pjesë e madhe e reformës rregullatore dhe reformës së strukturës institucionale është zbatuar.

Publikimi i të dhënave mbi zbatimin e planit gjithashtu është i vonuar dhe i pjesëshëm, gjë që dëmton analizën dhe përfshirjen si të aktorëve shtetërorë, ashtu edhe grupeve të interesuara.

4. REKOMANDIME

Në bazë të vlerësimeve të përputhshmërisë, mjaftueshmërisë, zbatimit dhe ndikimit - dalë nga analiza e dokumentacionit të përfshirë dhe monitorimit në terren - vlerësojmë se rekomandimet e mëposhtme do t'i shërbenin përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së ndikimit real të këtij plani veprimi:

Objektivat dhe masat

- **Specifikim më i qartë** i objektivave, masave dhe treguesve të monitorimit duke qartësuar **lidhjen** mes tyre për përmbushjen e masës dhe objektivit përkatës.
- Shkurtim në objektiva e masa që përbëjnë **veprime strategjike** për ndryshime ligjore, institucionale apo instrumentesh (dhe jo pune rutinë).
- Shoqërim me pikat kryesore të **strategjisë anti-korrupsion** dhe të **progresit të zbatimit** të planit paraardhës të veprimit (duke përfshirur ndarjen në afatshkurtër, afatmesme, afatgjatë e objektivave).

Afatet dhe kostot

- **Afate** që marrin parasysh vonesat në aprovimin e strategjisë në pjesën e parë të vitit si dhe vonesa në përgatitjen dhe aprovimin e raporteve vjetore.
- **Vlerësimi i kostos dhe alokimi financiar** që në fazën e hartimit të planit.

Procesi dhe përgjegjësitë

- **Proces gjithëpërfshirës konsultimi** gjatë hartimit të Planit të Veprimit - me institucionet zbatuese dhe grupet e interesit.
- **Informim dhe ndërgjegjësim** më i lartë mbi PV brenda strukturave të institucionit.
- **Përgjegjësi** në nivel Zv. Ministri për **monitorimin** e zbatimit të PV.

Ndikimi, informimi dhe transparencë

- **Matje dhe analizë e ndikimit** të zbatimit të masave specifike (ngritja dhe institucionalizimi i mekanizmave për *matjen e ndikimit*, përcaktimi i një niveli fillestar/baseline).

- **Informim dhe transparencë** maksimale në fazën e *hartimit*, *zbatimit*, dhe *raportimit* mbi PV – në institucionet zbatuese dhe me grupet e interesit.

5. BURIMET

Dokumente zyrtare

- Ligj Nr. 10 309, datë 22.7.2010 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, date 8.7.2010, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
- Ligj Nr. 10170, datë 22.10.2009, “Per disa ndryshime në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- Ligj Nr. 10185, Dt 26.11.2009 Për Një Ndryshim Dhe Një Shtesë Në Ligjin Nr. 8537, Datë 18.10.1999 “Për Barrët Siguruese”, të Ndryshuar.
- Ligj Nr. 8537, Datë 18.10.1999, Për Barrët Siguruese.
- Ligj Nr. 9524, Datë 25.04.2006 “Për Një Ndryshim Ne Ligjin Nr. 8537, Date 18.10.1999 ,, Për Barrët Siguruese.
- Ligj Nr. 9663, date 18.12.2006 “Per koncesionet”, i ndryshuar ka ndryshuar me Ligjin Nr. 10281, date 20.05.2010 “ Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine ligjit, Nr.1, date 05.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Për Koncesionet”.
- Ligj Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- Ligj Nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në R. Shqipërisë“.
- Ligj Nr.9643, Datë 20.11.2006, Ndryshuar me Ligjin Nr.9800 Datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855 Datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, Datë 22.10.2009, dhe Ligjin Nr.10 309, Date 22.07.2010 “Për Prokurimin Publik” <https://www.App.Gov.AL/Ep/Legislation.aspx>.
- Ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, ndryshuar me ligjin nr. Nr.10 346, datë 4.11.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”
- METE. Udhëzim Nr. 6278, Date 11.12.2000 “Për Miratimin e rregullores se barreve siguruese.
- METE. Urdhër Nr. 493, Datë 06/ 07/ 2006 Për Miratimin e rregullores se barreve siguruese.
- METE. Urdhër Nr. 494, Date 06.07.2006 Mbi Tarifat e Shërbimit te Regjistrimit te Barreve Siguruese.
- Urdher Nr. 70, dt. 18.04.2006 “Për Masat e Marra në Zbatim të Raporteve të KLSH, Auditit të Brendshëm dhe DKBAA, në Këshillin e Ministrave, në Institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”.
- UrdhërNr. 77, datë 5.4.2010 “Për Marrjen e Masave për Identifikimin e Aseteve Shtetërore që do të Përfshihen në Procesin e Privatizimit”.
- Vendim Nr. 1638, date 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”.
- VKM Nr. 385 datë 19.05.2010 “Për një Shtesë në Vendimin Nr. 538, Datë 26.5.2009 të Këshillit Të Ministrave “Për Licencat dhe Lejet që Trajtohen nga apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Disa Rregullime të Tjera Nënligjore të Përbashkëta”,

të Ndryshuar”. http://qpz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2010/PDF-2010/75-2010.pdf fq. 3981.

- VKM Nr. 506, datë 1.8.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- VKM Nr. 913, datë 26.8.2009 “Për Krijimin e Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike”
- VKM Nr. 635, dt. 23.07.2010 “Për miratimin e raportit për ndihmat shtetërore”.
- VKM nr.398, datë 26.05.2010 “Per Amendime ne Rregullat e Prokurimit Publik”.
- VKM Nr.45, datë 21.01.2009 “Për Kryerjen e Procedurave në Mënyrë Elektronike”. <https://www.app.gov.al/ep/VKM.aspx>

Burime dytësore

- Agjencia e Prokurimit Publik. Raporti Vjetor 2010. Fq. 13-14 <https://www.app.gov.al/ep/ReportsMonitorings.aspx>.
- Banka Botërore. Business Environment Reform and Institutional Strengthening <http://web.worldbank.org/external/projects/main?Projectid=P096643&theSitePK=40941&pagePK=64283627&menuPK=228424&piPK=73230>.
- Dhoma Amerikane e Tregtisë. Monitorimi i Përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik. Raporti Përfundimtar. <https://www.app.gov.al/ep/ReportsMonitorings.aspx>.
- Këshilli i Ministrave. Plan Veprimi 2010 për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin, Luftën Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen e Mirë
- Këshilli i Ministrave. Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes së Mirë 2008-2013.
- METE. Raport mbi Veprimtarine e Drejtorise se Auditimit te Brendshem ne METE (2010) http://mete.gov.al/doc/20110331104344_raport_vjetor_dab._2010.pdf.
- METE. Raporti i Ndihmës Shtetërore 2009.
- Papa, Helena. Prezntim në Forumin e PACA “Plan Veprimi anti-korrupsion 2011-2013 dhe roli i OJQ-ve”, Hotel Tirana International Tirane, dt. 16 Qershor 2011,
- Partners Albania. Raport Përfundimtar, Monitorimi i Performancës së Qendrës Kombëtare të Licensimit. http://www.partnersalbania.org/Monitorimi_QKL_Raport_Shqip_English.pdf.
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Si të Regjistrososh një Biznes. <http://www.qkr.gov.al/nrc/How_to_Register_a_Business.aspx>.
- Reed, Quentin. Comments on 2010 anti-corruption action plan and recommendations for future action plans. Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, June 2010. <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/Albania/Technical%20Papers/1917-PACA-TP-Reed-june10.pdf>.
- Reed, Quentin. Comments on selected ministries in 2010 Action Plan. Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, June 2010. http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/Albania/Technical%20Papers/1917-PACA-TP_QReed_June%2710_en.pdf.
- Reed, Quentin. The 2010 anti-corruption action plan, recommendations for next steps and further assistance. Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe,

July

2010.

<http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/Albania/Technical%20Papers/1917-PACA-TP-Reed-july10.pdf>.

Adresa interneti

- Agjencia e Prokurimit Publik.<<https://www.app.gov.al>>.
- Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj http://www.dsdc.gov.al/dsdc/DEBASKON_Departamenti_i_Strategjive_dhe_Koordinimit_me_Donatoret_5_1.php.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit <http://www.klsh.org.al/>
- Këshilli i Ministrave <http://www.km.gov.al>
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës www.mete.gov.al
- Privatizime.METE. www.privatizime.al
- Prokuroria e Përgjithshme <http://www.pp.gov.al>
- Qendra e Publikimeve Zyrtare: <http://www.qpz.gov.al/>
- Qendra Kombëtare e Licensimit. www.qkl.gov.al
- Qendra Kombëtare e Regjistrimit www.qkr.gov.al
- Regjistri Elektronik i Legjislacionit të Biznesit <http://www.rlb.gov.al/>